

VENDIM
Nr.274, datë 20.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.225, DATE 19.5.1993, TE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TARIFAT E REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT E TE
KALIBRIMIT FILLESTAR OSE PERIODIK TE MJETEVE MATËSE NËPRISHUAR ME
VENDIMET NR.268, DATË 19.6.1997, DHE NR.255, DATË 20.4.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE

Ne mbështetje të pikës 2, nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr.7625, datë 20.10.1992, “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë , me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pasqyrën nr.2, që bashkëlidhet vendimit nr.225, date 19.5.1993, te Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhet ky ndryshim:

Pas pikës 1.3 shtohet pika 1.4 me këtë përmbajtje:

“1.4. Aparatet matëse taksimetra 3 000 lekë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
PANDELI MAJKO

Analiza e koston për verifikimin e taksimetrave

Përbërësit e analizës së Koston

- Koha e punës e nevojshme për verifikim	3 orë
- Koha për vajtje ardhje në subjekt	30 orë
- Koha për mbushje dokumentacioni	30 min
- Koha për verifikim praktik	
- kontrolli i përgjithshëm i makinës dhe taksimetrit	30 min
- verifikimi i pagesës në kohë	30 min
- verifikimi i pagës me rrugë	1 orë

1. Shpenzime për pagesën e inspektorit

200 paga orare x 2 inspektore x 3 orë 1200 lekë

Shpenzime amortizimi bazës etalonuese 1000 lekë

- amortizimi i etaloneve të përdorur -----500 lekë

- shpenzime verifikimi bazës etalonuese -----500lekë

3. Shpenzime të automjetit -----300 lekë

- karburant 12 litrat x 90 lek/litri x 15km 200 lekë

- amortizimi orar automjetit 100 lekë

4. Shpenzime për bazë materiale dhe lëndë të parë 100 lekë

shuma =2600 lekë

5. Shpenzime administrative

20% e shumës 520 lekë

Çmimi real (shumë+shpenzime administrative).....3120 lekë

Çmimi i pranuar.....3000 lekë

